

Letër e hapur e Projektit lista e bardhë e Schengenit

Një rrugë përpara edhe për Kosovën!

Nëse Kosova mund të vihet në "listën e zezë" të vizave, pa një konsensus të BE-së rreth statusit të saj, atëherë ajo po ashtu mund të vendoset edhe në "listën e bardhë" kur të ketë përbushur kërkesat e nevojshme teknike. Procesi i liberalizimit të vizave duhet të konsiderohet nga BE-ja si neutral ndaj statusit

E mirëpresim propozimin e fundit të Komisionit Evropian në lidhje me liberalizimin e vizave në Ballkanin Perëndimor. Ky është një hap i rëndësishëm përpara në një proces që do t'u mundësojë popujve nga Ballkani Perëndimor, sikur edhe evropianëve të tjerë, që të udhëtojnë të lirë nëpër Evropë.

E çmujmë faktin që procesi i liberalizimit të vizave bazohet në kritere objektive. Qeveritë në rajon kanë detyrë që të zbatojnë reforma gjithëpërfshirëse për të përmirësuar sigurinë e BE-së dhe për të qetësuar brengat e qytetarëve të BE-së. Shtetet e Ballkanit Perëndimor janë kërkuar që të përmirësojnë kontrollin e kufijve të tyre, të futin në përdorim pasaporta biometrike që nuk mund të falsifikohen, dhe të vënë në vend strategji konkrete për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe emigracionit ilegal.

Tani, Komisioni Evropian ka gjetur se janë tri vende – Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi – që në masën më të madhe i kanë plotësuar këto kushte. Na vjen mirë që Komisioni Evropian është në një pozitë që të propozojë udhëtimin pa viza për ato. Kjo tregon se ky proces është duke funksionuar.

Në po ashtu shpresojmë që autoritetet në Shqipëri dhe në Bosnjë-Hercegovinë shumë shpejt do t'i përbushin kriteret e mbetura dhe të fitojnë qasjen pa viza në zonën e Schengenit para

jen e kësaj të vërtete të thellë, e jo të lejonin inkriminimin e tërë shoqërisë dhe institucioneve kosovare për krime lufte, siç ndodhi me librin Del Pontes.

Lidershipi kosovar në vend se të vajttojë se ja, na lanë jashtë procesit të liberalizimit të vizave, në geto etj., duke i ringjallur stigmat antievropiane e antiqytetëruese për Evropën plakë e kurvë, do të duhej t'i merrte së pari përgjegjësitë e veta shtetërore, ndaj shtetasve, që t'i çlirojnë nga stigma e krimeve, duke bashkëpunuar me hetuesit ndërkombëtarë për gjetjen e serbëve të zhdukur gjatë luftës në Kosovë, e pastaj t'i merrte edhe përgjegjësitë sipas së drejtës ndërkombëtare. Përgjegjësi të cilat Serbia, Bosnjë-Hercegovina dhe Kroacia, tashmë në mënyrën dhe intensitetin e duhur i kanë marrë duke themeluar gjykatat speciale për krime lufte dhe madje duke dënuar "të vetët" që kanë kryer krime lufte.

E vërteta që e thotë Krasniqi është tepër e vonuar, sepse në qeverisjen e vendit dhe në ndërtimin e shtetit ligjor shumicë janë vetë fantazmat ose fabrikuesit e tyre!

halil.matoshi@kohaditore.com

fundit të vitit 2010. Ne e mirëpresim faktin që Komisioni Evropian po i specifikon në detaje se cilat kushte ende mbeten për t'u plotësuar nga të dy vendet, duke siguruar një procedurë rigoroze dhe transparente.

Megjithatë, jemi të shqetësuar nga fakti se Kosova është lënë jashtë këtij procesi, me një mbulim me regjim vizash që është propozuar për të gjithë banorët e saj, përfshirë ata që kanë shtetësi serbe – kjo, pa përmendjen e çfarëdo procesi që do të mund të shpijë që kjo kërkesë të hiqet.

E dimë se shtetet anëtare të BE-së momentalisht nuk pajtohen rreth çështjes së pavarësisë së Kosovës. Megjithatë, të gjitha shtetet anëtare do të duhet të pajtohen se lenia e banorëve të Kosovës të të gjitha etnicitetëve të ngjuar në një geto vizash do të ishte një problem serioz – jo vetëm për Kosovën, por edhe për tërë Ballkanin Perëndimor, dhe interesat e BE-së në rajon.

Jemi të bindur se është në interes të BE-së që të inkurajohen të njëjtat reforma në Kosovë çfarë tash-

më kanë ndodhur në Maqedoni dhe Mal të Zi. Për ta bërë këtë, BE-ja duhet t'i përdorë resurset e konsiderueshme njerëzore dhe financiare që tashmë i ka të vendosura në Kosovë.

Duke pasur këtë në mendje, ne u bëjmë thirrje shteteve anëtare të BE-së – me çfarëdo goftë qëndrimi që kanë në lidhje me statusin e Kosovës – që të shqyrtojnë dy ndryshime në propozimin e Komisionit.

Së pari, Kosovës po ashtu duhet dhënë një hartë për rrugën përpara në çështjen e vizave. Asaj duhet t'i jepet mundësia për të zbatuar të njëjtat reforma të gjera që pesë shtetet e tjera të Ballkanit tashmë kanë nisur t'i zbatojnë dhe kështu t'i kontribuojë sigurisë së vet, sikur edhe të tërë rajonit dhe BE-së si tërësi. Kur Kosova t'i ketë plotësuar këto kushte, kërkesa për viza duhet të hiqet.

Nëse Kosova mund të vihet në "listën e zezë" të vizave, pa një konsensus të BE-së rreth statusit të saj, atëherë ajo po ashtu mund të vendoset edhe në "listën e bard-

hë" kur të ketë përbushur kërkesat e nevojshme teknike. Procesi i liberalizimit të vizave duhet të konsiderohet nga BE-ja si neutral ndaj statusit.

Së dyti, nuk duhet të ketë diskriminim kundër banorëve të Kosovës. Në përputhje me propozimin e Komisionit, 3,5 milionë serbët që jetojnë jashtë Serbisë, përfshirë serbët e Bosnjës, do të jenë në mundësi që të marrin pasaporta serbe që u lejon udhëtimin pa viza brenda BE-së. Banorët e Kosovës, ndërkohë, nuk mund ta kenë këtë. Ne nuk pajtohemi me këto mendime. Kjo do të ketë pasojë të pamenduara të inkurajimit të serbëve të Kosovës dhe (boshnjakëve të Kosovës) që të ndërrojnë vendbanimin dhe të vendosen jashtë Kosovës – si kundërtënie e hapur ndaj objektivës së dekluarar të BE-së për një Kosovë multietnike.

Me vite, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë pritur udhëtimin e lirë pa viza. Në marrëdhënien e rajonit me BE-në, pak çështje kanë qenë kaq të rëndësishme. BE-ja ka qëlluar në shën-

jestër me politikën e saj të hartës së kushtëzuar dhe strikte, por me vlerësime të drejta për rrugën përpara. Në interes të sigurisë evropiane – dhe ballkanike – ajo duhet të vazhdojë ndërtimin e mëtutjeshëm në këtë sukses.

Nënshkruar nga:

Giuliano Amato, kryesuesi i Bordit Këshilldhënës të Projektit lista e bardhë e Schengenit; Otto Schily, ish-ministër i Brendshëm i Gjermanisë, anëtar i

Bundestagut gjerman; Radmila Sekerinska, kryesuese e Këshillit Kombëtar për Integritim

Evropianë të Maqedonisë, ish-zëvendëskryeministër e

Maqedonisë; Misha Glenny, autor i librit "McMafia: krimi pa kufij", dhe disa libra të tjerë për

Ballkanin; Ivan Krastev, kryesues i Qendrës për Strategji Liberale,

Sofje; Jordi Vaquer, drejtor i Qendrës për Marrëdhënie

Ndërkombëtare dhe Studime Zhvillimore (CIDOB), Barcelonë; dhe Heather Grabbe, ish-

këshilltare e komisarit evropian për Zgjerim

Shprehu

Zyrtari injorant në telefon

Për çdo ditë, duke vajtur në punë në fengjese, kaloj pranë ndërtesës së Fakultetit Filozofik. Më kujtohet mirë, rruga quhet "Eqrem Çabej"! Ka kohë pra, që mëngjesve ec trotuarit me të fëlliqur të kësaj rruge. Letra, shishe plastike të hedhura andej-këtej, lëvore bananesh, qese bonbonesh që dikush i ka shkrirë me lezet në gojë – të gjitha këto mbeturina mbulojnë trotuarin para hyrjes anësore të kësaj ndërtese. T'i hedhin vallë këto mbetje studentët?! Apo, mbase e bëjnë dhjetëra lyp-sarë që s'të lënë sytë t'i hapësh ngado shkosh – në kafiteri, në veturë, rrugës... E pastron kush këtë qytet të shkretë? Sa para i marrin kompanitë për pastrim dhe a e përcjell kush punën e tyre?

Dje, rreth orës 2 e 30 të pasdites, shfletova "Kohën Ditore", mora numrin dhe i bëra një telefonatë Inspektoratit Komunal të Prishtinës. Personit që u lajmërua ia tregova arsyen pse po thërrija dhe e pyeta se ku mund ta adresoja ankesën time për papastërtinë e kësaj rruge, ndër më kryesoret në kryeqytet. Me tha që duhej të shkoja personalisht në Komunë për të deponuar këtë ankesë.

"Pse duhet të humb kohën e punës për të ardhur deri aty" - e pyeta. Sepse, më tha ai, përgjegjësit e Inspektoratit janë në terren dhe rrjedhimisht pra s'kisha me kë të flisja.

Mirë - i thashë atij që u lajmërua në telefonin zyrtar të Inspektoratit - a nuk ka asnjë aty që të flasë me mua, që së paku të marrë një shënim rreth këtij informacioni? Më tha që s'kishet! Po ju - pyeta - çfarë bëni aty?

Atëherë zyrtari anonim, që mund të mos ketë qenë edhe fare zyrtar, nisi të fliste shpejt, me nervozë, duke më thënë që s'kishte kohë të merrej me mua dhe të më jepte sqarime dhe... e mbylli telefonin!

Sigurisht, që në zgjedhjet e afërme lokale votën time s'do ta marrë dikush që ma mbyll telefonin kur kam ankesa për mospunën e tyre. Do të ishte e tmerrshme t'i jepja një vend pune një injoranti dhe arrogant si këtij "zyrtari" që ua mbyll telefonin qytetarëve, ndërkohë që merr rrogën nga taksat e tyre. Apo jo?

EB
Prishtinë

Nënshkruani: peticioni@koh.net

Të gjithë ata që duan të nënshkruajnë peticionin e nisur kundër politikës diskriminuese evropiane për liberalizim të vizave, që përjashton shqiptarët dhe boshnjakët, mund ta bëjnë këtë në adresën: peticioni@koh.net

Nënshkrimet më pas do të dërgohen tutje tek organizatorët e peticionit, nismëtarë të të cilit janë ish-përfaqësuesi i bashkësisë ndërkombëtare në Bosnjë, Christian Schwarz-Schilling, dhe personalitete të tjera të njohura politike e shoqërore evropiane. Peticioni kërkon që Komisioni Evropian të heqë dorë nga politika e liberalizimit të vizave që diskriminon viktimat e luftërave në ish-Jugosllavi – myslimanët e Bosnjës dhe shqiptarët e Kosovës, duke ua mohuar atyre udhëtimin e lirë në zonën e Schengenit, sikur që së fundi rekomandon t'u mundësohet qytetarëve të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Për më tepër, peticioni insiston se përfuttes nga politika e tillë diskriminuese e Brukselit do të jenë edhe serbët dhe kroatët e Bosnjës, sikur edhe serbët në Kosovë, duke e bërë kështu përkatësinë etnike kriter kryesor për vendosjen se kush mund të udhëtojë në zonën e Schengenit, pa viza e kush jo.

Grupi Koha në marrëveshje me organizatorët e hap këtë adresë, e cila do të vlejë për të gjithë qytetarët e Kosovës, por edhe për ata që jetojnë jashtë vendit.

Pra, nëse pajtohemi se rekomandimet e Komisionit Evropian që t'u hiqen vizat Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, por jo edhe shqiptarëve të Kosovës dhe boshnjakëve të Bosnjës, janë të padrejta, dërgojni një e-mail në adresën peticioni@koh.net dhe emri juaj do t'u bashkohet nënshkruesve të këtij peticioni që do t'u dorëzohet institucioneve më të rëndësishme të Bashkimit Evropian, dhe që tashmë është nënshkruar nga shumë politikanë dhe personalitete nga mbarë Evropa, përfshirë aty edhe anëtarët e Parlamentit Evropian, gazetarë dhe aktivistë të ndryshëm që kanë punuar me vite të tëra në rajonin e Ballkanit.

Shkruani një e-mail me shënime tuaja personale: emri, mbiemri, profesioni, qyteti dhe shteti ku jetojnë - dhe dërgojni këtë porosi në adresën: peticioni@koh.net

Nënshkrimi juaj shton presionin.

peticioni@koh.net

Rubrika e përhershme "Shprehu" është krijuar si hapësirë e "Kohës ditore" për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve. Të gjitha shkrimet nuk duhet të jenë më të gjata se 500 fjalë. Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës. Opinionet e shprehura në këtë rubrikë nuk përfaqësojnë qëndrimet e redaksisë.